



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2
23.04.2013

NR. VENDIMI 5
17.04.2014

V E N D I M
“MBI KONFISKIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej :

K / Seance : **DRITAN HALLUNAJ**
Anëtar : **FRAN PRENDI**
Anëtar : **KLODIAN KURUSHI**

me sekretare të seancës gjyqësore **Ankela DAKE**, mori në shqyrtim sot me **dt. 17.04.2014** në seancë çështjen administrativo-penale me Nr. 2 / 8 Akti, të vitit 2013, që i përket:

PADITËS: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda - Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Edvin Kondili**.

TË PADITUR: **1. A.L.**, i datëlindjes xxx, lindur ne xxx, xxx, xxx dhe banues në xxx, Rr. xxx, xxx, me kombësi dhe shtetësi xxx, i përfaqësuar në mungesë të tij, nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, **av. A.P.**, me nr. License xxx dhe numër Nipti xxx, avokat i Dhomës së Avokatisë xxx.

2. P.G., i datëlindjes xxx, lindur xxx, xxx dhe banues në xxx, xxx, xxx me kombësi dhe shtetësi Italiane, i përfaqësuar në mungesë të tij, nga mbrojtësi i zgjedhur me vullnetin e

tij me deklarinim ne seance gjyqesore, **av. F.D.**, me nr. License xxx dhe numër Nipti xxx, avokat i Dhomës së Avokatisë xxx.

OBJEKTI : **Konfiskimin e pasurive**, shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx”, xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi;

Dëgjoji përfaqësuesin e organit të akuzës, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës dhe konkretisht:

I. Konfiskimin e shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx”, xxx.

II. Për administrimin e kësaj pasurie, të ngarkohet **z. K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi konfiskimi, të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx.

Dëgjoji përfaqësuesin e palës së paditur A.L., avokatin A.P., i cili përfundimisht kërkoi: Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Dëgjoji përfaqësuesin e palës së paditur P.G., avokatin F.D., i cili përfundimisht kërkoi: Rrëzimin e kërkesës së organit të akuzës dhe heqjen e sekuestros si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N S E:

Pranë kësaj gjykate ka paraqitur një kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për **konfiskimin** e pasurive të shtetasve xxx, të paditurve **A.L.** dhe **P.G.**, konkretisht konfiskimin e shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx”, xxx.

Rezultoi e provuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx ka regjistruar procedimin penal nr.xxx, te vitit xxx, per vepren penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Ky procedim penal ka filluar pas informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Tiranë, e cila ka bërë bllokim në bazë të ligjit, të shumës së transferuar nga **A.L.** nga xxx, për shkak të dyshimeve se shuma e mësipërme është produkt i një veprimtarie kriminale. Në kushtet e urgjencës është vendosur me vendim të Prokurorit sekuestrimi i shumës xxx euro pranë bankës “xxx” në kuadër të procedimit penal të regjistruar për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Më pas me vendimin nr.xxx, datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx është vendosur dhe sekuestro preventive e shumës së mësipërme.

Duke patur parasysh ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx me shkresën nr. xxx Prot. datë xxx ka dërguar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë materialet në ngarkim të shtetasve **A.L.** dhe **P.G.**

Kjo Prokurori i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me objekt sekuestrimin e shumës xxx euro pranë bankës “xxx”.

Gjykata duke analizuar se ekziston një rrezik real dhe potencial që pasuria e luajtshme, pra shuma monetare të tjetërsohet, apo të humbasë në rast të shfuqizimit të sekuestros vendosur ne funksion të procedimit penal, bazuar në nenin 11/1, pikat “a” dhe “b” të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009, kjo gjykatë me

vendimin nr.12 datë 01.11.2012 ka vendosur:

- **Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.**
- **I.** Sekuestrimin e shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx, xxx.
- **II.** Për administrimin e kësaj pasurie, të ngarkohet **z. K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- **III.** Për ekzekutimin e këtij vendimi konfiskimi, të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.
- Për palët e interesuara afati i ankimit fillon nga momenti i marrjes dijeni.

Sipas parashikimeve ligjore pas një periudhe kohore të caktuar, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me një kërkesë me objekt konfiskimin e pasurisë, shumës xxx euro pranë bankës “xxx”, shtetasve xxx **A.L.** dhe **P.G.**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për konfiskim, gjykata ka bërë njoftimet për anën e paditur, shtetasit xxx **A.L.** dhe **P.G.**, sipas adresave të dhëna nga organi i akuzës, si palë paditëse.

Njoftimi është dërguar me letër-porosi në shtetin xxx në adresat përkatëse.

Për shtetasin xxx **P.G.**, është bërë njoftimi me anë të letër-porosisë dhe ky shtetas me datë xxx është paraqitur në seancë gjyqësore duke marrë njoftim në lidhje me kërkesën për konfiskimin e shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, dhe ky shtetas ka zgjedhur si përfaqësues të tij në këtë gjykim avokatin F.D., i cili ishte dhe personi përgjegjës i caktuar nga ai për çdo njoftim që do i bëhej, duke dhënë si adresë të tij në xxx atë të avokatit të tij.

Ne lidhje me njoftimin e shtetasit **A.L.** është bërë njoftimi me anë të letërpodosisë drejtuar autoriteteve xxx të Drejtësisë në adresën e banimit të tij, dhënë nga pala paditëse (Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë), dhe nga ana e këtyre autoriteteve nuk është bërë e mundur gjetja dhe njoftimi i tij në adresën e dhënë.

Gjykata konform nenit 22 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, vendosi që njoftimi për këtë shtetas të bëhej nëpërmjet policisë gjyqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pergjigja e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit konfirmonte faktin që ky shtetas nuk gjendej në territorin e Republikës së Shqipërisë, në këto kushte konform nenit 22 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 gjykata deklaroi mosgjetjen e personit të paditur **A.L.** duke i caktuar atij një avokat kryesisht për të mbrojtur interesat e tij në këtë gjykim.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështje ka rezultuar se:

Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Tiranë, ka bërë bllokim në bazë të ligjit, të një shume të transferuar nga i padituri **A.L.** nga xxx, për shkak të dyshimeve se shuma e mësipërme është produkt i një veprimtarie kriminale.

Dyshimet se shuma e transferuar është produkt i veprave penale kanë lindur në bazë të faktit se shtetasi xxx **A.L.**, **në datat xx - xxx** ka kryer dy transfertë drejt xxx nga xxx, në total shumën xxx euro. Sipas deklarimeve të bëra prej tij në bankën xxx, në momentin e transfertave, kjo shumë parash vinte nga *“shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimore në xxx”*. Përfituesi i këtyre transfertave në Bankën “xxx” në xxx ishte shoqëria “xxx” xxx, pronë e shtetasve xxx G. (G.) C., R. dhe R.C.

Dega e kësaj shoqërie në Shqipëri është regjistruar pranë QKR-së me datë xxx, me numër NIPT xxx, me objekt të veprimtarisë “punime ndërtimi për vepra civile, aktivitet guroreje, tregtimi me shumicë i materialeve të ndërtimit, ndërtimi dhe tregtimi i pasurive të paluajtshme për banim ose jo, etj”.

Pas kryerjes së këtyre transfertave, **në datën xxx** shoqëria “xxx” xxx ka

transferuar brenda bankës “xxx” shumën xxx euro në drejtim të shoqërisë “xxx” xxx me përshkrim “*kthim fondi për moskryerje investimi*”.

Rezulton se Shoqëria “xxx” xxx, është një shoqëri italiane me qendër në xxx e cila nuk është e regjistruar në Q.K.R.

Nga data xxx deri në xxx nga numri i llogarisë së shoqërisë “xxx” xxx janë bërë tre tërheqje “cash” nga i padituri P.G., në datën xxx shuma xxx euro, në datën xxx shuma xxx euro dhe në datën xxx shuma xxx euro, në total xxx euro.

Shtetasi P.G. shumën prej xxx euro të ngelura në llogari ka kërkuar ta transferojë në xxx, në një nga llogaritë e shoqërisë së tij atje, apo në llogarinë e një shoqërie tjetër xxx atje “xx” xxx. Duke qene se arsyetimi i klientit se këto fonde do të transferoheshin me qëllim hapjen e një filiali të shoqërisë në Shqipëri u pa nga banka si i pabazë, si dhe duke munguar dokumentacioni justifikues për transferimin e këtij fondi bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, Banka “xxx” nuk e kreu transfertën. Pas refuzimit të transfertes nga ana e Bankes xxx, P.G. është regjistruar si person fizik në QKR në datën xxx me fushe veprimtarie “tregeti me pakice veshje”. Si i tillë ai ka hapur një llogari në bankën xxx dhe me pas ka kërkuar serish nga banka “xxx” te transferonte fondet e tij ne llogarinë e re.

Nisur nga dyshimet që banka kishte mbi arsyet e kryerjes se transaksionit nuk e ka kryer atë dhe e ka raportuar pranë DPPPP si një rast të dyshimtë. Shtetasi P.G. është përpjekur vazhdimisht me anë të telefonit të kryejë transfertën e shumës prej xxx euro nga llogaria e tij në Bankën “xxx” në llogarinë e tij në bankën xxx. Komunikimi është kryer me ane të telefonit, pasi ai ka deklaruar se ndodhej në Itali gjatë atyre ditëve. Banka sërish ka refuzuar të kryejë transaksionin dhe i ka kërkuar P.G. të sjellë dokumentacionin e duhur për kryerjen e transfertes. Në datën xxx P.G. ka dërguar me anë të faksit disa dokumenta në bankën “xxx”, për të vërtetuar burimin e fondeve që kërkonte të transferonte. Shtetasi P.G. ka pretenduar se këto dokumenta janë dërguar me faks nga xxx, ndërkohë që në këto dokumenta është bërë i padukshem numri i faksit nga i cili janë dërguar.

Shuma e sekuestruar është transferuar nga shtetasi A.L., ndërkohë që nga

të gjitha aktet nuk rezulton që shtetasi A.L. të ketë lidhje me shoqërinë “xxx” xxx. E vetjma e dhënë sipas dokumentacionit të dërguar tek “xxx” Banka nga P.G., është ajo në marrëveshjen e datës xxx lidhur në xxx, xxx ku shtetasi P.G. ka nënshkruar si i autorizuar nga A.L., por në fakt nuk ka asnjë akt që ta tregojë këtë. Kjo marrëveshje është zgjidhur në datën xxx me anë të një deklaratë të nënshkruar në xxx nga P.G. dhe G.C.

Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se G.C. është larguar nga Shqipëria në datën xxx duke hyrë përsëri në datën xxx, pra në datën xxx kur rezulton se ka nënshkruar këtë deklaratë nuk ka qënë në Shqipëri. Po kështu dokumentacioni i depozituar nga “xxx” tek Banka “xxx” për transferimin e shumës xxx euro në datën xxx është tërësisht i ndryshëm nga i njëjti dokumentacion i depozituar nga P.G. për tërheqjen e shumës. Aktmarrëveshja midis “xxx” xxx dhe “xxx” xxx këtu është e datës xxx dhe ndryshon në përmbajtje dhe formatin e shkrimit. Në përmbajtje bëhet fjalë për ndërtimin e një reparti të Klinikës “xxx” në xxx nga “xxx” me fonde të mbledhura nga “xxx” xxx në shumën xxx euro, ndërsa në marrëveshjen e datës xxx depozituar nga P.G. bëhet fjalë për studimin e tregut dhe një projekt investimi për hapjen e degës së “xxx” xxx në xxx. Përveç kësaj, në datën e kësaj marrëveshje të lidhur më xxx në xxx, xxx, shtetasi G.C. që rezulton se ka firmosur ka qënë në Shqipëri nga data xxx deri në datën xxx.

Në një dokument tjetër, kontratë shërbimi e datës xxx (pas bllokimit të shumës) midis “xxx” xxx dhe P.G. nënshkruar në xxx, shoqëria “xxx” xxx (nuk dihet se nga kush është firmosur për “xxx” xxx) do ti paguajë P.G. një shumë paradhënie prej xxx euro (shuma e mbetur në bankën xxx) për shërbimet që ky do të kryejë, si kontrollin e cilësisë së produkteve në Shqipëri, etj, pra shuma e mësipërme del për një qëllim krejtësisht tjetër nga deklaratet e bera në dokumentacionin e mëparshëm të depozituar në Bankën “xxx”.

Ndërkohë që nuk ka llogjikë që shtetasi P.G. të nënshkruajë kontratë me veten e vet duke qënë përfaqësues i shoqërisë xxx. Gjithashtu, vihet re se i gjithë dokumentacioni i paraqitur nuk është hartuar pranë një noteri, por janë vetëm deklarata midis palëve, si dhe duke parë justifikime të ndryshme të shumës së sekuestruar, faktin që llogaria bankare e “xxx” xxx pranë bankës “xxx” është hapur në datën xxx kur është transferuar shuma dhe dokumentacioni i zgjidhjes

se marrëveshjes midis palëve për të justifikuar transferimin e shumës mban po këtë datë ka arsye për të besuar se ky dokumentacion është fiktiv.

Në vijim personat e përfshirë në këto transaksione rezultojnë persona me precedentë penale, konfirmuar fillimisht nga Zyra Ndërlidhëse e Policisë Italiane Interforcë dhe aktualisht konfirmimi zyrtar për precedente penale në lidhje me personat e përfshirë në transaksionet me shumën e sekuestruar ka ardhur nga Zyra e Interpolit në muajin xxx të vitit xxx me shkresën nr.xxx, ndërsa me shkresën e fundit nr.xxx date xxx jemi informuar se DPPPP është ende në investigim të këtij rasti dhe vijon korrespondencën me homologët sllovenë për të marrë të dhëna të tjera.

Shtetasi **A.L.**, lindur me xxx, ne xxx/xxx, dhe banues në xxx, Rr.xxx, xxx njihet nga autoritetet italiane si person i dënuar për krime në fushën financiare si mashtrim me dëmtim, mashtrim i falimentit, hapje e paligjshme e kreditit.

Po kështu, shtetasi **P.G.**, lindur me xxx, xxx (xxx), dhe banues xxx nr.x, njihet si person me aktivitet kriminal edhe ai për krime ekonomike si mashtrim, përvetësim e falsifikim. Në vitet xxx-xxx ky shtetas ka grumbulluar një shumë prej xxx euro dhe xxx euro nga një vetpunësim i padeklaruar tek një kompani me qendër në xxx, e cila e ka mbyllur aktivitetin në dt. xxx.

Gjithashtu, përfaqësuesit e kompanisë “xxx”, **G.C.**, lindur më xxx në xxx dhe banues në Rr.xxx dhe **R.C.**, lindur me xxx në xxx dhe banues në Rr.xxx, njihen nga autoritetet xxx si persona me aktivitet kriminal për veprat penale të thyerjes së ligjit për tenderat dhe mashtrim.

Për këtë arsye pas kryerjes së hetimeve të mësipërme, është kërkuar marrja e informacionit dhe provave nga autoritetet kompetente gjyqësore italiane dhe ato gjermane, lidhur me procedimet penale të regjistruara jashtë shtetit në ngarkim të shtetasve xxx **A.L.**, **P.G.**, **G.C.** dhe **R.C.**, identifikimin e pasurive, të luajtshme apo të paluajtshme, të përfituara nga veprat penale, të cilat mund t`u jenë sekuestruar në shtetin xxx shtetasve P.G. dhe A.L., informacion për shoqëritë tregëtare “xxx” xxx, “xxx” xxx, “xx” xxx, nëse ka ndonjë aktivitet kriminal apo dënime penale në ngarkim të këtyre shoqërive, informacion për shtetasin **A.L.**, nëse për këtë shtetas autoritetet xxx kanë të dhëna për aktivitetin e tij në xxx dhe pasuri të fituara apo të regjistruara në këtë

shtet prej tij, konkretisht duke i`u referuar deklaramit të tij në bankën xxx për prejardhjen e parave “nga shitja e një zixhiri dyqanesh në xxx”, si dhe çdo informacion tjetër të vlefshëm në lidhje me vepra penale dhe përfitime të siguruara prej këtyre veprave në ngarkim të shtetasit A.L. apo shtetasve të tjerë të përmendur më lart.

Me shkresën nr.3487/3 datë 28.3.2012 është përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme materiali i ekzekutimit të letërporosisë nga autoritetet xxx të drejtësisë. Më këtë letërporosi autoritetet xxx kanë informuar se për asnjë nga shtetasit e përmendur më sipër nuk ka informacion në xxx. Në këto kushte, nga përgjigja e autoriteteve xxx të drejtësisë rezulton se burimi i të ardhurave të transferuara ***nuk konfirmohet të jetë ai i deklaruar nga shtetasi A.L. “nga shitja e një zixhiri dyqanesh në xxx”.***

Të gjitha këto fakte mbështesin dyshimin se shuma e sekuestruar mund të jetë produkt i një veprave/veprave penale ose i veprimtarisë kriminale të kryer nga shtetasit A.L. dhe P.G., nga ku kanë rrjedhur të ardhurat e sekuestruara.

Në këtë gjykim në zbatim te nenit 21/3 te ligjit nr.10192 datë 03/12/2009 **“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**, barra e provës i bie të paditurit, në rastin konkret dy shtetasve xxx A.L. dhe P.G., që të provojnë para gjykatës ligjshmërinë e shumës që kërkohet të konfiskohet, por nga ana e tyre nuk u paraqit asnjë provë që të vërtetonin pretendimet e tyre.

Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për konfiskimin e pasurive të shtetasve A.L. dhe P.G., kjo për faktin se pas kryerjes së të gjitha verifikimeve në gjykim, provohet plotësisht se shuma prej xxx euro, dërguar nga shtetasi A.L. dhe është tentuar të transferohet nga shtetasi P.G. e gjendur pranë bankës “xxx”, **është e pajustificuar dhe ka dyshime se rrjedh nga burimet kriminale.**

Po të kemi parasysh Nenin 24 te ligjit nr.10192 datë 03/12/2009 **“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**, ku shprehimisht thuhet:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;
- b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe
- c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesëshëm apo të plotë personit”.

Ne rastin objekt gjykimi, me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore rezulton se plotësohen kërkesat e nenit 24/1 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, për konfiskimin e pasurisë prej xxx euro, pasi **së pari**: ka dyshime të arsyeshme për pjesëmarrje në aktivitet kriminal të anës së paditur, kjo e vërtetuar me provat e administruara në gjykim ku rezulton se shtetasi **A.L.** njihet nga autoritetet italiane si person i dënuar për krime në fushën financiare si mashtrim me dëmtim, mashtrim i falimentit, hapje e paligjshme e kreditit dhe i padituri tjetër **P.G.** njihet si person me aktivitet kriminal edhe ai për krime ekonomike si mashtrim, përvetësim e falsifikim.

Së dyti: nuk provohet prejardhja e ligjshme e kësaj pasurie, pra me provat e administruara provohet se shuma e transferuar nga shtetasi xxx, i padituri A.L., në masën xxx euro vinte nga “*shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimore në xxx*” dhe përfituesi i këtyre transfertave në Bankën “xxx” në Shqipëri ishte shoqëria “xxx” xxx. Dega e kësaj shoqërie në Shqipëri është regjistruar pranë QKR-së me objekt të veprimtarisë “punime ndërtimi për vepra civile, aktivitet guroreje, tregëtimi me shumicë i materialeve të ndërtimit, ndërtimi dhe tregëtimi i pasurive të paluajtshme për banim ose jo, etj”.

Autoritetet xxx në lidhje me pretendimin e të paditurve se shuma e mësipërme vinte nga “*shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimore në xxx*”, kanë informuar se për asnjë nga shtetasit **A.L.** dhe **P.G.** nuk ka informacion në xxx.

Në këto kushte, nga përgjigja e autoriteteve xxx të drejtësisë rezulton se burimi i të ardhurave të transferuara **nuk konfirmohet të jetë ai i deklaruar nga**

shtetasi A.L. “nga shitja e një zixhiri dyqanesh në xxx”.

Dhe **së treti**: konstatohet se pasuria është në disponim të plotë të personave të paditur.

Prandaj sa më sipër gjykata konkludon se shuma monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx”, xxx, duhet **të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.**

Për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 urdhërohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx, ndërsa për administrimin e kësaj pasurie ngarkohet z. K.Xh., i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 3,7,21 dhe 26, të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

V E N D O S I :

- **Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.**
- Konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të shumës monetare prej xxx (xxx) euro, e gjendur në llogarinë nr. xxx, pranë bankës xxx, në xxx, me adresë: xxx “xxx”, xxx.
- Për administrimin e kësaj pasurie, të ngarkohet **z. K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi konfiskimi, të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurve.
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë për palën

prezent dhe për palën në mungesë ky afat ankimi fillon nga momenti i marrjes dijeni.

– **U shpall në Tiranë, me dt. 17.04.2014.**

SEKRETARE

GJYQTAR

ANKELA DAKE

DRITAN HALLUNAJ